UNIONE ARBERIA

LIDHJA ARBËRIA

MENSILE BILINGUE DI INFORMAZIONE - ANNO II - N. 7 - GIUGNO 2010

GAZETË E PËRMUAJSHME NJOFTIMI DYGJUHËSHE - VITI II-Nr. 7-THERISTI 2010

DIFFUSIONE GRATUITA / *SHPRISHJE E LIRË*

IN QUESTO NUMERO / *TE KY NUMËR:*

- **Legge 15 dicembre 1999, n. 482 (Artt. 13-16) / *Ligji 15 dhjetor 1999, nr. 482 (Nenet 13-16)*** **p. 1**
- **S. COSMO A. Inaugurazione del busto di Giorgio Castriota Scanderbeg / *STRIGAR. Zbulim i bustit të Gjergj Kastriota Skënderbeut*** **p. 2**
- **ARBERIA. Unità d'Italia 150 anniversario: Come parteciparono gli arbëreshë all'Indipendenza; presentato volume di Giuseppe Martino su ribelle Stratigò / *ARBËRI. Përvjetori i 150të i Bashkimit të Italisë: Si muartin pjesë arbëreshët tek Pavarësia; u prezentua vëllimi i Giuseppe Martino-s mbi rebelit Stratigò*** **p. 3**
- **VACCARIZZO A. Concorso vini arbëreshë 2010 / *VAKARIC. Konkursi "Verat Arbëreshe 2010"*** **p. 3**
- **S. COSMO A. Il magistrato Minisci racconta la Giustizia Italiana / *STRIGAR. Gjyqtari Minisci e rrëfyen Drejtësinë Italiane*** **p. 3**
- **S. DEMETRIO C. Il PD chiede un centro unico prenotazioni in paese / *SHËN MITËR.* PD-*u kërkon një qendër të vetëm rezervimesh ndë katund*** **p. 4**
- **S. GIORGIO A. Le notti dell'arte sangiorgese / *MBUZAT. Netët e artit mbuzacjot*** **p. 4**
- **S. DEMETRIO C. Gli studenti americani sbarcano a S. Demetrio / *SHËN MITËR. Arrëvuan studentët amerikanë*** **p. 4**
- **S. SOFIA D'E. XVII Rassegna culturale folcloristica per la valorizzazione delle minoranze etniche a Caraffa. Successo per la scuola di S. Sofia d'E. / *SHËN SOFI. Manifestimi XVII kulturor folklorik për vlerësimin e pakicavet etnike në Garrafë. Sukses për skollën e Shën Sofisë*** **p. 5**
- **VACCARIZZO A. Premiazione Concorso letterario / *VAKARIC. Dhënia çmimesh për Konkursin letrar*** **p. 5**
- **S. DEMETRIO C. Gara balcone più bello e saggio di ballo / *SHËN MITËR. Gara e pexherit më të bukur dhe Prova e Valljes*** **p. 5**
- **Cultura italo-albanese e tradizione popolare / *Kultura arbëreshe dhe tradita popullore: Kangjelet për Festën e Kungimit, për nder të Shën Andonit dhe të Shën Pjetrit*** **p. 6**
- **S. DEMETRIO C. Applausi per il musical "Hair" / *SHËN MITËR. Duartrokitje për shfaqjen muzikore* "Hair"** **p. 8**
- **ARBERIA. Incontro con lo scrittore Carmine Abate / *ARBËRI. Takim me shkrimtarin Carmine Abate*** **p. 8**
- **ARBERIA. La musica arbëreshe nella Grande Mela / *ARBËRI. Muzika arbëreshe Nju-Jork*** **p. 8**

LEGGE 15 DICEMBRE 1999, N. 482 (Artt. 13-16)
"Norme in materia di tutela delle minoranze linguistiche storiche"
(Testo approvato in via definitiva dal Senato della Repubblica Il 25 novembre 1999; pubblicato sulla G.U. del 20.12.1999)

(*continua dal num. 6-Maggio 2010*)

Art. 13

1. Le regioni a statuto ordinario, nelle materie di loro competenza, adeguano la propria legislazione ai principi stabiliti dalla presente legge, fatte salve le disposizioni legislative regionali vigenti che prevedano condizioni più favorevoli per le minoranze linguistiche.

Art. 14

1. Nell'ambito delle proprie disponibilità di bilancio le regioni e le province in cui siano presenti i gruppi linguistici di cui all'articolo 2 nonché i comuni ricompresi nelle suddette province possono determinare, in base a criteri oggettivi, provvidenze per l'editoria, per gli organi di stampa e per le emittenti radiotelevisive a carattere privato che utilizzino una delle lingue ammesse a tutela, nonché per le associazioni riconosciute e radicate nel territorio che abbiano come finalità la salvaguardia delle minoranze linguistiche.

Art. 15

1. Oltre a quanto previsto dagli articoli 5, comma 1 e 9, comma 2, le spese sostenute dagli enti locali per l'assolvimento degli obblighi derivanti dalla presente legge sono poste a carico del bilancio statale entro il limite massimo complessivo annuo di lire 8.700.000.000 a decorrere dal 1999.

(segue a pag. 2)

LIGJI I DATËS 15 DHJETOR 1999, NR. 482 (Nenet 13-16)
"Normat në lidhje me mbrojtjen e pakicavet gjuhësore historike"
(Teksti i miratuar në formë përfundimtare nga Senati i Republikës, më 25 nëntor 1999; i botuar në G.Z. të datës 15.12.1999)

(vazdhon ka numri 6-Maj 2010)

Neni 13

1. Krahinat me statut të zakonshëm, në çeshtjet e përfshira nën kompetencat e tyre, ia përshtasin legjislacionin e tyre parimeve të përcaktuara nga ky ligj, përveç dispozitave legjislative krahinore në fuqi, që parashikojnë kushte më të favorshme për pakicat gjuhësore.

Neni 14

1. Brenda mundësive që lejon bilanci i tyre, krahinat dhe provincat në të cilat ndodhen grupe gjuhësore për të cilat flitet në nenin 2, si edhe bashkitë e përfshira në provincat e mësipërme mund të përcaktojnë, në bazë të kritereve objektive, kushtet për botime, për organet e shtypit dhe për stacionet radiotelevizive private, që përdorin një nga gjuhët e pranuar nën tutelë, si edhe për shoqatat e njohura dhe të vendosura në territor, që e kanë si qëllim mbrojtjen e pakicave gjuhësore.

Neni 15

1. Veç rasteve të përfshira në nenin 5, paragrafi 1 dhe 9, paragrafi 2, shpenzimet e enteve lokale për përmbushjen e detyrimeve që krijon ky ligj vihen në ngarkim të bilancit shtetëror, brenda limitit maksimal të përgjithshëm vjetor prej 8.700.000.000 lirash, duke filluar nga viti 1999.

(vazhdon tek faqja e 2të)

(segue da pag. 1)

2. L'iscrizione nei bilanci degli enti locali delle previsioni di spesa per le esigenze di cui al comma 1 è subordinata alla previa ripartizione delle risorse di cui al medesimo comma 1 tra gli enti locali interessati, da effettuare con decreto del Presidente del Consiglio dei Ministri.
3. L'erogazione delle somme ripartite ai sensi del comma 2 avviene sulla base di un'appropriata rendicontazione, presentata dall'ente locale competente, con indicazione dei motivi dell'intervento e delle giustificazioni circa la congruità della spesa.

Art. 16
1. Le regioni e le province possono provvedere, a carico delle proprie disponibilità di bilancio, alla creazione di appositi istituti per la tutela delle tradizioni linguistiche e culturali delle popolazioni considerate dalla presente legge, ovvero favoriscono la costituzione di sezioni autonome delle istituzioni culturali locali già esistenti.

(vazhdon ka faqja e 1rë)

2. Regjistrimi në bilancet e institucioneve lokale i parashikimeve të shpenzimeve për nevojat e përfshira në paragrafin 1 bëhet pas ndarjes së burimeve të përfshira në të njëjtin paragraf 1 mes enteve lokale të interesuara, dhe kryhet me dekret të Presidentit të Këshillit të Ministrave.
3. Shpërndarja e shumave të ndara, sipas paragrafit 2, bëhet në bazë të një raporti të përshtatshëm, të paraqitur nga institucioni lokal kompetent, me saktësimin e qëllimeve të proiektit dhe justifikimin e përshtatshmërisë së shpenzimit.

Neni 16
Krahinat dhe provinçat mund t'e marrin përsipër, brenda mundësive të bilancit të tyre, krijimin e instituteve për mbrojtjen e traditave gjuhësore dhe kulturore të popullsive të konsideruara nga ky ligj ose t'e ndihmojnë krijimin e seksioneve autonome të institucioneve lokale ekzistuese.

SAN COSMO ALBANESE
Inaugurazione del busto di Giorgio Castriota Scanderbeg

Mercoledì 2 giugno l'Amministrazione comunale di S. Cosmo A. ha organizzato, con il patrocinio della Regione Calabria e della Provincia di Cosenza, una cerimonia di inaugurazione del busto dell'eroe nazionale albanese Giorgio Castriota Scanderbeg, donato al Comune di S. Cosmo A. dalla Repubblica d'Albania, in seguito ad accordi di cooperazione culturale tra Albania e Italia, al fine di rafforzare e intensificare i proficui rapporti soprattutto con i comuni e le regioni in cui la Comunità arbëreshe continua a coltivare gli antichi legami storici, linguistici e culturali con il Paese albanese. Questo evento è stato celebrato con la massima solennità e alla presenza di rappresentanti di alto livello della Repubblica Albanese: Neritan Ceka, Consigliere Culturale del Presidente del Consiglio dei Ministri della Repubblica Albanese, e Arben Skënderi, Consigliere Culturale MTKRS (Ministero del Turismo, Cultura, Politiche Giovanili e Sport); era presente inoltre lo scultore dell'opera Gentjan Tabaku. Il busto è stato sistemato in una nuova piazzetta denominata per l'occasione "Largo Scanderbeg" e, al momento dello scoprimento dell'opera, la banda musicale di S. Cosmo A. ha eseguito i rispettivi inni nazionali. Dopo la benedizione del parroco papàs Pietro Minisci, il corteo si è trasferito nella Casa della Cultura, dove, dopo i saluti del Sindaco dott. Antonio Mondera, il prof. Belmonte ha tenuto una relazione sulla figura storica dell'eroe albanese. Gli interventi degli ospiti d'Albania sono stati tradotti in simultanea dalla dott.ssa Adriana Ponte, operatrice dello Sportello linguistico dell'Unione Arberia; era presente all'evento anche il prof. Francesco Altimari, responsabile della cattedra di Albanologia all'Università della Calabria, e alcuni Sindaci delle comunità vicine. La serata è stata allietata da canti della tradizione culturale arbëreshe, che hanno coinvolto gran parte del pubblico presente.

STRIGAR
Zbulimi i bustit të Gjergj Kastriota Skënderbeut

Të mërkurën 2 theristi Administrata Bashkiake e Strigarit organizoi, me mbrojtjen e Krahinës së Kalabrisë dhe të Provinçës së Kosenxës, një ceremoni për inaugurimin e bustit të heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriota Skanderbeg, çë Republika e Shqipërisë ia dha Bashkisë së Strigarit, pas mirëkuptimeve të kooperimit kulturor ndër Shqipëria dhe Italia, sa të përforcohen dhe të intensifikohen marrëdhëniet e leverdishme, kryesisht me bashkitë dhe krahinat në të cilat Komuniteti arbëresh vazhdon të mbanjë lidhjet e vjetra historike, gjuhësore dhe kulturore me Shqipërinë. Kjo ngjarje u kremtua me solemnitetin dhe me praninë e përfaqësuesvet të mëdhenj të Republikës së Shqipërisë: Neritan Ceka, Këshilltar Kulturor i Presidentit të Këshillit të Ministravet të Republikës së Shqipërisë, dhe Arben Skënderi, Këshilltar Kulturor i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportëve; ish edhe skulptori i veprës Gentjan Tabaku. Busti qe ndrequr tek një shesh të ri të emërtuar për këtë rast "Sheshi Skanderbeg" dhe, kur vepra u zbulua, banda muzikore e Strigarit ekzekutoi himnet kombëtare. Pas bekimit të famullitarit zoti Pietro Minisci, kortezhi u transferua tek Shpia e Kulturës, ku, pas përshëndetjevet të kryetarit dokt. Antonio Mondera, prof. Belmonte diovasi një ligjëratë mbi figurën historike e heroit shqiptar. Pjesëmarrjet e mikpritësvet shqiptarë qenë përkthyer njëkohësisht ka dokt.sha Adriana Ponte, operatore e Sportelit gjuhësor të Lidhjes Arbëria; ish edhe profesori Francesco Altimari, përgjegjës i katedrës së Albanologjisë tek Universiteti i Kalabrisë, dhe disa kryetarë të katundevet të afërme. Mbrëmja qe gazmuar ka këngët e traditës kulturore arbëreshe, çë përzjetën publikun e pranishëm.





Nelle foto: a sinistra, donne in costume davanti al busto di Scanderbeg; a destra, il Sindaco Antonio Mondera dopo lo scoprimento del busto dell'eroe.
Tek fotografitë: ka e majta, gra të veshura llambadhor përpara bustit të Skënderbeut; ka e djathta, kryetari Antonio Mondra pas zbulimit të bustit të heroit.

ARBERIA
Unità d'Italia 150 anniversario: Come parteciparono gli arbëreshë all'Indipendenza; presentato volume di Giuseppe Martino su ribelle Stratigò

All'Unità d'Italia ed alla realizzazione del suo sogno, 150 anni fa, parteciparono i calabresi ma anche gli albanesi d'Italia. A questa vicenda è dedicato il libro di Giuseppe Martino "Eterne sono le idee", presentato martedì 1 giugno a Catanzaro nella sala Augusto Placanica della Biblioteca comunale, su iniziativa dell'Assessorato comunale alla Cultura. Il libro è dedicato alla storia di un ribelle, Vincenzo Stratigò, di Lungro, uno dei paesi italo-albanesi della provincia di Cosenza. Alla presentazione con l'autore hanno discusso il commissario dell'Ardis di Catanzaro e autrice della prefazione al volume, Rita Commisso e gli storici Cesare Mulé e Ulderico Nisticò. L'assessore comunale alla Cultura Antonio Argirò ha deciso di dare continuità con una serie di dibattiti che il comune organizzerà tenendo conto proprio del 150/mo anniversario dell'Unità d'Italia.

VACCARIZZO ALBANESE
Concorso "Vini arbëreshë 2010"

Si è tenuto sabato 12 giugno, il Concorso "Vini arbëreshë 2010" a Vaccarizzo Albanese presso Palazzo N. Marino. Il Concorso, patrocinato dalla Regione Calabria, dalla Provincia di Cosenza e dall'Arssa, ha visto gareggiare una sessantina di produttori di vini provenienti da tutti i paesi arbëreshë, in particolare da San Martino di Finita, Santa Sofia D'Epiro, San Demetrio Corone, San Cosmo, San Giorgio, Vaccarizzo Albanese, Civita e Frascineto. I produttori hanno presentato un centinaio di vini tra passiti, bianchi e rossi. Erano presenti alla manifestazione l'Onorevole del PD e Presidente dell'Unione Arberia, Cesare Marini e Antonio Farina, biologo, medico chirurgo e sommelier, di Montegiordano, che ha presentato il libro "Principi per la vinificazione domestica delle uve nere". Alla fine della manifestazione il sindaco di Vaccarizzo, Aldo Marino ha premiato i vini migliori del comprensorio arbëresh. Al primo posto per la categoria dei vini rossi si è classificato Giorgio Ferraro, di San Giorgio Albanese; primo classificato per i vini bianchi Mario Azzinnari, di Santa Sofia D'Epiro e al primo posto per i passiti si è piazzata Maria Venere Scorza, sempre di Santa Sofia D'Epiro. A giudicare i vini l'Associazione Sommelier di Cosenza di cui è presidente Gennaro Convertini, che ha effettuato i test e gli assaggi sui campioni di vino pervenuti. Dopo la premiazione si è tenuta la festa con degustazione dei vini. La serata è stata allietata dal concerto del gruppo "I Priapi" di San Demetrio.

SAN COSMO ALBANESE
Il magistrato Minisci racconta la giustizia italiana



È originario di San Cosmo Albanese il magistrato della Procura di Roma, Francesco Minisci, autore di un volume dal titolo "La giustizia italiana raccontata da un alieno" edito da Rubbettino. Francesco Minisci ha studiato a San Demetrio, frequentando per cinque anni il Liceo di Sant'Adriano conseguendo la maturità classica. Nel suo volume il Pm racconta come la giustizia italiana sia un sistema precario pieno di incongruenze, con i cittadini spesso lasciati smarriti di fronte all'incertezza della pena; quanto facile sia divenuta la vita per i "colletti bianchi" che delinquono in Italia; quanto sia redditizio per gli imprenditori lucrare illegittimamente fondi dall'Unione Europea. Alla Procura di Roma, dove è giunto dopo quella di Cosenza, Minisci è tra l'altro titolare della nuova inchiesta aperta per far luce sulla morte di Pier Paolo Pasolini. La prefazione del volume, già in libreria, è di Luca Palamara, Presidente dell'Associazione Nazionale Magistrati e l'introduzione è firmata da Giuseppe Maria Berruti, Membro del Consiglio Superiore della Magistratura.

ARBËRI
Përvjetori i 150të i Bashkimit të Italisë: Si muartin pjesë arbëreshët tek Pavarësia; u prezentua vëllimi i Giuseppe Martino-s mbi rebelit Stratigò

Tek Bashkimi i Italisë dhe tek realizimi i ëndrrës së saj, 150 vjet praptë, muartin pjesë kalabrezët por edhe arbëreshët. Kësaj pjese të historisë i kushtohet libri i Giuseppe Martino-s "Të pavdekshme janë idetë", i paraqitur të martën 1 theristi Katanxar tek salla Augusto Placanica *të Bibliotekës bashkiake, me nismën e Asesoratit bashkiak për Kulturën. Libri fjet për historinë e një rebeli, Vincenzo Stratigò, ka Ungra, një ka katundet arbëreshe të provinçës së Kosenxës. Tek paraqitja me autorin foltin për këto gjëra komisari i* Ardis *ka Katanxari dhe autorja e parathënies së vëllimit, Rita Commisso, dhe historianët Cesare Mulé dhe Ulderico Nisticò. Asesori bashkiak për Kulturën Antonio Argirò e vendosi t'i japë vazhdimësi me një seri diskutimesh çë Bashkia ka të organizonjë tue marrë parasysh pikërisht përvjetorin e 150të të Bashkimit të Italisë.*

VAKARIC
Konkursi "Verat Arbëreshe 2010"

Të shtunë 12 theristi Vakaric, tek Pëllasi "N. Marino", u mba Konkursi "Verat Arbëreshe 2010". Te konkursi, i mbrojtur ka Krahina e Kalabrisë, Provinça e Kosenxës dhe ka Arssa, *muartin pjesë rreth gjashtëdhjetë prodhues verash çë vinjen ka gjithë katundet arbëreshe, në veçanti ka Shën Mërtiri, Shën Sofia, Shën Mitri, Strigari, Mbuzati, Vakarici, Çivëti dhe Frasnita. Prodhuesit paraqitin rreth njëqind vera ndër pasite, të bardha dhe të kuqe. Ishin të pranishëm tek shfaqja i nderuari i* PD-*ut dhe President i Lidhjes Arbëria, Cesare Marini dhe Antonio Farina, biolog, kirurg dhe* sommelier, *ka Montegiordano, çë paraqiti vëllimin "*Principi per la vinificazione domestica delle uve nere*". Në fund të shfaqjes kryetari i Vakaricit, Aldo Marino i dha çmimet e veravet më të mira të katundevet arbëreshe çë muartin pjesë. Në vendin e parë për kategorinë e veravet të kuqe u klasifikua Giorgio Ferraro, ka Mbuzati; i pari i klasifikuar për verat e bardha qe Mario Azzinnari, ka Shën Sofia dhe në vendin e parë për pasitet u klasifikua Maria Venere Scorza, edhe kjo ka Shën Sofia. I zgjodhi verat Shoqata Italiane* Sommelier *ka Kosenxa të së cilës është President Gennaro Convertini, çë bëri provat dhe ngjerimet mbi kampionet e veravet të ardhura. Pas dhënies çmimesh u mba festa me ngjerimin e veravet. Mbrëmja u gëzua me koncertin e grupit "*I Priapi*" ka Shën Mitri.*



STRIGAR
Gjyqtari Minisci e rrëfyen Drejtësinë Italiane

E ka origjinën ka Strigari gjyqtari i Prokurës së Romës, Francesco Minisci, autor i një vëllimi me titullin "La giustizia italiana raccontata da un alieno" të botuar ka Rubbettino. *Francesco Minisci studioi Shën Mitër, ku e ndoqi per pesë vjet Liçeun e Shën Adrianit, tue marrë diplomën e maturës klasike. Tek vëllimi i tij Prokurori rrëfyen sa i pasigurt është sistemi i Drejtësisë italiane, pjot me mungesa koherence, çë shumë herë i lëren qytetarët të bjerrë përpara pasigurisë së denimit; sa e lehtë u bë jeta për "jakat e bardha" çë bënjen krime në Itali; sa e frytshme është për sipërmarrësit të fitonjen në mënyrë të paligjshme fonde të Lidhjes Europiane. Tek Prokura e Romës, ku erdhi pas asaj të Kosenxës, Minisci është edhe titullari i hetimit të ri ç'u hap të bëhet dritë mbi vdekjen e Pier Paolo Pasolini-t. Parathënia e vëllimit, tashmë në librari, është i Lukës Palamara, President i Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëvet dhe hyrja është e nënshkruar ka Giuseppe Maria Berruti, Anëtar i Këshillit të Lartë të Institucionit të Drejtësisë.*

SAN DEMETRIO CORONE
Il PD chiede un centro unico prenotazioni in paese

Importante iniziativa del segretario del circolo cittadino del Pd, Demetrio Damico, intesa ad alleviare i disagi per la mancanza in paese di un Cup sanitario (centro unico di prenotazioni) che invece sono operativi ad Acri e a Corigliano. Con una lettera indirizzata, con allegate le firme di consenso dei cittadini che avallano l'iniziativa, al Commissario straordinario dell'Asp (Azienda sanitaria provinciale di Cosenza), Damico ha chiesto che venga istituito anche a San Demetrio, un Cup per le prenotazioni degli esami e delle prestazioni specialistiche, evitando, in particolare ad anziani e non solo, di recarsi ad Acri e Corigliano. "L'iniziativa, rende noto il segretario, si associa all'impegno già profuso dall'amministrazione comunale che si è già attivata, per ottenere il centro prenotazioni". Il segretario ha inoltre aggiunto che "la fattibilità del progetto è supportata dall'esistenza nel nostro comune di un Poliambulatorio, struttura funzionante ed adeguata e di recente costruzione con relativo personale. Pertanto l'istituzione del servizio non comporterebbe spese eccessive. Dall'istituzione del servizio deriverebbe un indubbio vantaggio non solo per i sandemetresi ma anche per gli abitanti dei paesi limitrofi. L'iniziativa ha riscosso l'appoggio di molti cittadini.

SHËN MITËR
PD-*u kërkon një qendër të vetëm rezervimesh ndë katund*


Nismë me rëndësi ajo e sekretarit të qarkut qytetar të PD-*ut, Demetrio Damico, çë e ka qëllimin çë t'i lehtësonjë shqetësimet për mungesën e një qendre të vetme rezervimesh shëndetësore ndë katund (*Cup*) si ato çë përkundrazi vepronjen Akër dhe Kurëlanë. Me një letër, me nënshkrimet miratimi e qytetarëvet çë e mbronjen nismën, të drejtuar Komisarit të jashtzakonshëm të Ndërmarrjes shëndetësore provinçale të Kosenxës (*Asp*), Damico kërkoi çë të themelohej edhe Shën Mitër një qendër për rezevimet e kontrollevet mjekësore dhe të shërbimevet specialistike, veçanërisht për pjeqtë por jo vetëm, kështu çë të mos bën e venë ata Akër dhe Kurëlanë. "Nisma, bën të njohur sekretari, e shoqëron zotimin tashmë të marrë ka administrata bashkiake çë u vu në lëvizje më parë, sa t'e ketë qendrën rezervimesh". Sekretari pra shtoi se "është një projekt çë mund të bëhet edhe pse te katundi jonë ekziston një Poliklinikë, një strukturë çë shërben, e përshtatshme dhe e ndërtuar pak mot praptë me personel përkatës. Për këtë, themelimi i shërbimit nëng kërkon shpenzime të rënda. Ka krijimi i shërbimit kish të dilë një fitim i sigurt jo vetëm për shënmitrotët por edhe për banuesit e katundevet afër. Nisma e korri mbështetjen e shumë qytetarëve.*

SAN GIORGIO ALBANESE
Le notti dell'arte sangiorgese



Anche quest'anno il Comune di San Giorgio Albanese mette in mostra i suoi tesori artistici esposti nella Pinacoteca comunale, testimonianze per la comprensione dell'arte e della storia sangiorgese. Nella Pinacoteca sono esposti 11 maestosi dipinti e 8 affreschi realizzati dal pittore Petrit Ceno, attorno a due grandi temi: la venuta degli albanesi in Italia, la vita e le opere dei poeti e scrittori italo-albanesi. La Pinacoteca comunale, sede del Consiglio comunale, oltre a conservare ed accrescere il patrimonio artistico, è un luogo di esposizione ed educazione all'arte e alla storia. L'apertura notturna vuole invogliare la gente a visitare la mostra approfittando delle ore notturne meno calde. Proprio per rendere più piacevole la visita, è prevista un'accoglienza musicale, coinvolgendo le associazioni concertistiche sangiorgesi.

MBUZAT
Netët e artit mbuzacjot



Edhe simbjet Bashkia e Mbuzatit i nxjerr tharosët e saj artistikë të ekspozuara tek Pinakoteka bashkiake, si dëshmitarë për mirëkuptimin e artit dhe të historisë mbuzacjote. Te galeria gjenden 11 piktura të madhërishme dhe 8 afreske të realizuara ka piktori Petrit Ceno, mbi dy tema të mëdha: ardhja e shqiptarëve në Itali, e jeta dhe veprat e poetëvet dhe shkrimtarëvet arbëreshë. Pinakoteka bashkiake, seli e Këshillit të Bashkisë, nëng shërben vetëm sa t'e vjonjë dhe sa t'e zgjeronjë trashëgiminë artistike, por është edhe një vend për ekspozimin dhe edukimin ndaj artit dhe historisë. Hapja e natës do të sjellë gjindjen sa të shohë ekspozitën tue përfituar ka hera më pak e ngrohtë e natës. Dhe sa të bëhet një vizitë më e këndshme, parashikohet mirëpritja muzikore, tue i ndërlikuar

SAN DEMETRIO CORONE
Gli studenti americani sbarcano a S. Demetrio

Anche quest'anno gli studenti americani dell'Università di Rodhe Island sono sbarcati a San Demetrio Corone, per il consueto periodo di studi e approfondimenti di lingua italiana, storia, cinema, cucina. Gli universitari, coordinati dal Professore di Lingua e Storia italiana, Michelangelo La Luna, sono circa 15, provengono anche dalla vicina Boston e da altre città degli States e sono arrivati dalla famosa università verso la prima settimana di giugno. Un altro gruppo di studenti raggiungerà il professore a fine luglio. Una novità caratterizza lo stage di quest'anno: La Luna insieme al professor Renato Guzzardi dell'Unical di Cosenza, stanno girando, con il contributo di alcuni dei ragazzi dell'università, alcune scene esclusive del film "Il ritorno di Norman" tratto da un libro di Norman Douglas, che sarà anche oggetto di studi in America. Un esperimento portato avanti senza budget particolari, che in seguito verrà ricostruito e riassemblato negli Stati Uniti.

SHËN MITËR
Arrëvuan studentët amerikanë

Edhe simbjet studentët amerikanë e Universitetit të Rodhe Island *arrëvuan Shën Mitër, për periudhën e zakonshme studimesh dhe thellimesh mbi gjuhën italiane, historinë, kinematografinë, kuzhinën. Universitarët, e bashkërenditur ka Profesori i Gjuhës dhe Historisë italiane, Michelangelo La Luna, janë rreth 15, vinjen edhe ka* Boston *dhe qytete të tjera të Shtetevet të Bashkuara dhe erdhën ka universiteti i njohur rreth javës së parë të theristiut. Një grup tjetër studentësh ka t'ia arrinjë profesorit tek fundi i muajit të llonarit. Një gjë e re e karakterizon stazhin e këtij viti: La Luna, bashkë me profesorin Renato Guzzardi të Universitetit të Kalabrisë, është e xhiron, me ndihmën e disa të rinjve të universitetit, disa skena ekskluzive të filmit "*Il ritorno di Norman*" të nxjerrë ka një libër ka Norman Douglas, çë ka të jetë edhe objekt studimi në Amerikë. Një eksperiment i sjellë përpara pa buxhete të veçanta, çë pra ka të rindërtohet dhe të rimontohet tek Shtetet e Bashkuara.*

SANTA SOFIA D'EPIRO
XVII Rassegna culturale folcloristica per la valorizzazione delle minoranze etniche a Caraffa. Successo per la scuola di Santa Sofia d'Epiro

Si è aggiudicata il terzo premio per l'esibizione la scuola di Santa Sofia d'Epiro, che ha partecipato anche quest'anno alla Rassegna culturale per le minoranze linguistiche, organizzata dall'Istituto Comprensivo Statale "A. Pitaro" di Borgia e dalla Scuola Secondaria di 1° grado di Caraffa.
La manifestazione, ormai divenuta un'immancabile tradizione che coinvolge gli Istituti Comprensivi di tutte le comunità di minoranza in Calabria, quest'anno si è tenuta a Caraffa il 22 e il 29 maggio.
Il 22 maggio si è svolta la Conferenza dal tema "Il rapporto Cultura Identità". Il 29 maggio si è tenuto il Raduno delle Scuole partecipanti che quest'anno erano dodici: Caraffa, Bova Marina, Contessa Entellina, Falconara Albanese, Frascineto, Guardia Piemontese, Piana degli Albanesi, Gizzeria, Plataci, San Basile, Santa Sofia D'Epiro, Vena di Maida. Nel primo pomeriggio ha avuto luogo la sfilata dei gruppi-scuola lungo le vie di Caraffa di Catanzaro, con a capo i sindaci in rappresentanza delle comunità partecipanti.



SHËN SOFI
Manifestimi XVII kulturor folklorik për vlerësimin e pakicavet etnike në Garrafë. Sukses për skollën e Shën Sofisë

Mori çmimin e tretë për shfaqjen më të mirë skolla e Shën Sofisë, çë muari pjesë edhe simbjet tek Manifestimi kulturor për pakicat gjuhësore, i organizuar ka Instituti Përmbledhës Shtetëror "A. Pitaro" në Borgia dhe ka Skolla e Mesme e Garrafës. Manifestimi, çë tashmë u bë një traditë e pamungueshme çë i përzien Institutet Përmbledhëse të komunitetevet të gjitha pakicore në Kalabri, simbjet u mba Garrafë (CZ) më 22 dhe 29 maj. Më 22 maj u mba Konferenca me temën "Relacioni Kultura Identitet". Më 29 maj u mba Mbledhja e Skollavet çë muartin pjesë, çë simbjet ishin dymbëdhjetë: Garrafa (CZ), Bova Marina (RC), Kundisa (PA), Fallkunara (CS), Frasnita (CS), Guardia Piemontese (CS), Hora e Arbëreshëvet (PA), Xhiceria (CZ), Pllatëni (CS), Shën Vasili (CS), Shën Sofia (CS), Vina (CZ). Pasditën u mba parakalimi i grupëvet skollash gjatë udhëvet të Garrafës, të udhëhequra ka Kryetarët e Komunitetevet çë muartin pjesë.

VACCARIZZO ALBANESE
Premiazione Concorso letterario

Domenica 20 giugno a Vaccarizzo Albanese, presso Palazzo "N. Marino", si è tenuta la premiazione del Concorso letterario di scrittura creativa: "Parole e Versi sulle ali della fantasia", organizzato dall'Amministrazione comunale, che ha coinvolto le quinte classi della Scuola Primaria e la Scuola secondaria di I grado dell'Istituto Comprensivo di San Giorgio Albanese. La premiazione è stata inserita all'interno della manifestazione scolastica di fine anno, che ha visto esibirsi gli alunni della Scuola Primaria con la rappresentazione "Il mago di Oz" e gli alunni della Scuola Secondaria di I grado con la rappresentazione teatrale "Peter Pan". Questi i vincitori del concorso: al primo posto, per la classe V della Scuola Primaria si è classificata Carmela Garofalo di San Cosmo Albanese; per quanto riguarda la Scuola Secondaria di I grado, nella classe I, al primo posto si è classificata Celeste Mondera di San Cosmo Albanese; nella classe II, Miriam De Cicco di San Giorgio Albanese; mentre nella classe III, Lucrezia Faraco di Vaccarizzo Albanese. La serata si è conclusa con l'esibizione di balli e canti in arbërisht da parte degli alunni della Scuola Secondaria di I grado di Vaccarizzo e di San Giorgio diretti dal prof. Pino Cacozza.

VAKARIC
Dhënia çmimesh për Konkursin letrar

Të diel 20 theristi Vakaric, tek Pëllasi "N. Marino", u mba dhënia çmimesh e Konkursit letrar të shkrimit krijues: "Fjalë dhe Vargje mbi pendët e fantazisë", të organizuar ka Administrata bashkiake dhe çë interesoi klasat e pesta të Skollës fillore dhe Skollën e Mesme e Institutit Përmbledhës së Mbuzatit.
*Çmimet u dhanë mbrënda manifestimit skollor të fundit të vitit, gjatë së cilit dualltin në skenë nxënësit e Skollës fillore me shfaqjen "Magjistari i Ozit" dhe studentët e Skollës së Mesme me shfaqjen teatrale "*Peter Pan*".*
Këto fituesit e konkursit: tek vendi i parë i klasës V të Skollës Fillore u klasifikua Carmela Garofalo ka Strigari; për sa i takon Skollës së Mesme, për klasën e parë, tek vendi i parë u klasifikua Celeste Mondera ka Strigari; për klasën e dytë, Miriam De Cicco ka Mbuzati, kurse për klasën e tretë Lucrezia Faraco *ka Vakarici.*
Mbrëmja u mbulli me shfaqjen e studentëvet të Skollës së Mesme të Vakaricit dhe të Mbuzatit çë dualltin në skenë me vallje dhe kënga arbërisht, të drejtuara ka prof. Zek Kakoca.

SAN DEMETRIO CORONE
Gara balcone più bello e saggio di Ballo

Si è tenuta il 19 giugno a San Demetrio la Prima Edizione del concorso "Balcone in fiore", organizzata dal consigliere con delega allo sport, Damiano Cadicamo, con il patrocinio dell'Amministrazione comunale. Questa prima edizione ha visto la partecipazione di 30 famiglie di San Demetrio. L'intento è stato quello di promuovere le bellezze del comune arbëresh ed era aperto a tutte le famiglie del paese. Premiati il primo e il secondo balcone giudicato più bello e meglio ornato dagli addobbi floreali, da una giuria nominata per l'occasione. I balconi sono stati filmati e fotografati. I vincitori: al primo posto "balcone più bello" la famiglia Braico, al secondo posto la famiglia Caputo, al terzo posto la famiglia Solano e al quarto posto la famiglia Fuscaldo. La premiazione è avvenuta presso la palestra comunale. Sempre sabato la Pro Loco di San Demetrio ha organizzato in collaborazione con l'amministrazione comunale di San Demetrio e l'Associazione "Libertas Coronei" e la School Dance sandemetrese, la V Edizione del Saggio di fine anno. La manifestazione, denominata "Ballando con le stelle", ha visto impegnati diverse coppie di ballo e i maestri Rita Muto, Antonio Spadafora, Edvige Bilotti e Marco Spadafora. Anche questo avvenimento si è svolto nella palestra comunale di via Caminona.



SHËN MITËR
Gara e pexherit më të bukur dhe Prova e Valljes

U mba më 19 theristi Shën Mitër Organizimi i Parë i konkursit "Pexher me lule", të organizuar ka këshilltari me delegim për sportin, Damiano Cadicamo, me përkrahjen e Administratës së Bashkisë. Te kjo shfaqje muartin pjesë 30 familje ka Shën Mitri. Qëllimi qe ai çë të nxitëshn bukuritë e katundit arbëresh dhe mund të mirrnin pjesë familjat e gjitha të katundit. Një komision i zgjedhur për rastin ua dha çmimin të parit dhe të dytit pexher të menduara më të bukura dhe të stolisura më mirë me lulet. Të gjithë pexherët qenë filmuar dhe fotografuar. Fituesit: tek vendi i parë familja Braico, tek i dyti familja Caputo dhe tek i treti familja Solano dhe tek i katërti familja Fuscaldo. Dhënia e çmimevet u mba tek palestra bashkiake.
*Akoma të shtunën ProLoco–ja e Shën Mtrit e organizoi, me bashkëpunimin e administratës së Bashkisë së Shën Mitrit, Shoqatës "*Libertas Coronei*" dhe Skollës* School Dance *shënmitrote, Organizimin e V të Provës së fundit të vitit. Tek shfaqja, e emërtuar "Tue luajtur me ylëzit", muartin pjesë shumë çifte çë luajtin bashkë dhe mjeshtrit Rita Muto, Antonio Spadafora, Edvige Bilotti dhe Marco Spadafora. Ngjarja u mba tek palestra bashkiake tek udha Caminona.*

Cultura italo-albanese e tradizione popolare / *Kultura arbëreshe dhe tradita popullore*

Canti per il Corpus Domini, per Sant'Antonio e per i Santi Pietro e Paolo / *Kangjelet për Festën e Kungimit, për nder të Shën Andonit dhe të Shën Pjetrit*

Il Corpus Domini, che quest'anno ricorre il 6 giugno, è una solennità in onore dell'Eucarestia, non prevista dal Calendario liturgico bizantino, ma presa "in prestito" dai latini; viene istituita da Urbano IV l'8 settembre 1264. Si celebra il giovedì seguente la domenica della SS. Trinità, 12 giorni dopo la Pentecoste.

Festa e Kurmit të Krishtit, çë simbjet bie më 6 theristi, është një festë e madhe për nder të Kungimit, çë nëng kemi te kalendari liturgjik bizantin, por çë morëm "hua" ka lëtirët; u themelua ka Urbani IV më 8 vjesht 1264. Festohet të enjtën çë pason të dielën e Trinisë së Shënjtë, 12 ditë pas Rrëshajës.

(S. Demetrio C. - S. Cosmo A. / *Shën Mitër - Strigar*)
SAKRAMEND I QIELLVET

Versione unificata di 2 canti presi da / *Variant i njësuar i 2 Kangjeleve të marrë ka:*
Pier Emilio Acri, Salvatore Bugliaro, Pasquale De Marco, *La Chiesa Matrice di San Demetrio Corone. Storia – Tradizioni – Archivio*, con prefazione di Giuseppe Faraco, Effe Graf, Mirto Crosia, 1996;
Giulio Variboba, *Vita della Beata Vergine Maria (1762)*, Ed. critica e trad. italiana a cura di V. Belmonte, Rubbettino, Soveria Mannelli, 2005, pagg. 222-236 (vv. 2367-2538).

Sakramend i qiellvet,
buk'e gjall'e ëngjëlvet,
nga orë të kultonj
nga mumend u të bekonj.
Shpirti im, ngreu, gëzo
tundu, zëmër, e këndo!
Njo! Zoti vjen e të gjën
Krishti vet vjen e të prën.
O, fërtunë! O dinjitat!
O sa graxje somenat!
Ynzot, çë të do mirë
bukë u bë e më bën hir.
Buk'u bë, ma, o, si të fryn!
Shpirt e kurm e përtërin.
Kjo bukë shpirtin e zgjon
edhe kurmin bukuron.
Zbardhet zëmra si skamëngje
zbutsonet më se qëngje.

Kurmi i Krishtit ë' një huall
çë cukar e mjal' na suall.
Kur e ha, duket kolëndër
më e ha, më s'ke të ndëndër.
Zëmra vet tija t'e thotë
se me 'të është Ynzot.
S'i ke besë këto hajdhi?
Ea, pravoji, ashtu i di.
Krishti vjen pa gapari
vell të bardhë vu për stoli.
Me këtë vell dritën mbuloi,
vetëhenë s'e ndikuroi.
Vet ahiena ka hare
kur na thotë se vdes për ne.
Mbulli sytë e mos penxar
se s'e sheh nëng 'mbortar'.
Besa e gjall' tij t'e bufton
besa vetëm t'e zbulon.
Sa më ti besë e ke
më e sheh e ke hare.
Besa tij dreq t'e thot':
«Ruaj këtu: ësht' Ynzot».
Mos pushtron Ai vetëhenë
me këtë vell, me këtë trenë,
thoni, ëngjëlit e mi,
si mund rronj' i ziu njeri?
Kjo dritë kish t'e verbonej
e ky zjarr kish t'e fërnonej,
kish të bij' me çer' përmist'
kish të humbej nd'at' Pist'.
Krisht është ai pekurar
çë për delezët dish vrar'.
Gjaku i tij dhent' shëroi,
ngrah i vu e i sallvoi.
Qaga e Krishtit skaturir'
një sapur, një ardur të mir'.
Del si krua një dhullçic,
del një t'ëmbël, një llegric.
Benmio, të kesh të rrie
nat' e dit' atje të pie.
Mbrepa, qasu, ea pi,
mbjoi pjot ato bulshi.
Kurmi dehet e dhifiset,
shpirti digjet e zaliset.
Zëmra thërret e thot':
"O, çë zjarrm ç' ësht' Ynzot!".
Ka Parrajsi, për një fjal',
prindi i par' u gjënd dal'.
Me një pem' çë i dha si mik
e gënjeu Çifari i lik.
Me një pem' gjarpëri i zi
farmëkosi gjithnjeri.
O, sa lot', o, sa të qar'
suall ngullia e gruas s' par'!
Ma kjo pem', ky mustacuall
gjith' të mirat na suall.

Kur e merr e e ha me mall,
shpirtin mbjatuna t'e ngjall,
t'e shëron, t'e konfurtar',
t'e gëzon, t'e konxullar'.
S'ka pagur se vdes njeri
kur e ha me shum' ngulli.
Krishti fjet: "Si Ynzot
bëni ju çë ha'i sot".
Ndë këtë tryez' ulemi paru,
ma së ngrëhemi gjith' paru.
Shpirti i mir' i pamëkat'
zbardhet më se fol kart'.
Shpirti pjot vakëndari
del si pis', si nj' ur i zi.
O, hundim, o, nëm'e keqe!
Vet të bëhesh herëkeqe!
Ka kjo buk' të jesh lavosur,
ka Krishti farmëkosur!
Më mir' mos ishe ler'
se të kungosh ndë këtë maner'.
Ma, ojme!, dikush thërret.
Vuxha e Krishtit, por ti qet':
"Bīr, ndë je gjarpër i zi,
ndë ke nodhje me njeri,
ndë ti ke mallinjitat,
mos u qas këtu somenat.
Bën paq', rrestituir,
qaj mëka'n, bëhu i mir',
se kjo tryez' nëng ë' për qent',
ë' për shëjtet, për parthent'.
Për këta kam lipisi,
nat' e dit' rri filaqi.
O, me sa mall u i pres,
o, të gjegjshit si thërres!
Eni qas'i, miqt' e mi,
u për ju ruani tek rri.
O, të dijit sa duronj
kur ju ve'i e u qëndronj!
U këtu ju shoh tek jini,
tekdo ve'i e tekdo ngi'ni,
kushdo ditën më kulton,
kushdo zëmrën më zbulon.
O, me sa mall u ju pres,
pjes her' më vjen të vdes!".
Ashtu ë', oj Zot, vërtet'
se ti sembre na thërret.
Majdhe, ësht' për maravil'
sa ti bën për atë fëmil'.
Gjith' Parrajsin vure mb' udh',
e mbylle nd'atë fëlludh'.
Rri i mbëllijtur dit'e nat',
shih mos je një namurat.
Nëng fjë, nëng të qëllon,
nëng varesen, nëng pushon.
Rri e pret sembre, si prind,
ashtu një si edhe njëqind.

Një orolloxh përjashta rri
si një kartë me ghramati,
ma përmbrënda kā një mil'
rrota, xhëngje e maravil'.
Ky kumbit ndë këtë maner'
duket buk' e duket ver',
ma përmbrënda ë' një tërzuar,
ë' Parrajsi i tër' i vjuar.
Jan' të mira sa të duash,
ë' Zotīn, çë ke të thuash?
Ora, na çë pa'm fërtun'
e pravuam këtë micikun,
xhaka gjith' jemi të ngrën',
xhaka gje'm Parrajsin tën,
gjith' përgjunj këtu somenat'
ulemi kësaj Maestat.
Bekonjëm Sakramend',
këtë Rregj onipotend;
thomi gjith' një këng' të re
se t'i bënjëm hare.
Bashk' me t' A'n e me të Bir',
Shpirti i Shëjt ç'ë' shum' i mir';
Zoti Krisht ndë sakramend
çë na bëri gjithë kutjend,
edhe Zonja e Shën Mëri
çë na suall këto hajdhi
nat'e dit' qoftë llaudhartur,
bekuar e rringraxjartur,
për sa ghraxje e sa hare
somenat bëri me ne.
Ar't njëhere ajo menat',
vaçim sot nd'atë mbitat,
tek zbuluar shoku yn'
bën me ëngjëlit kumbi'n'.
Faqe faqe shihemi,
dora dora zëhemi,
valle valle mbjidhemi,
si vëllezër duhemi.
Sembre paq e sembre bashk',
sembre gaz e sembre Pashk
por ndë rrolet t' bufet's
sa të jet' jeta e jet's.

(S. Cosmo A. - S. Giorgio A. / *Strigar - Mbuzat*)
RACJONA E SËN ANDONIT

Il primo canto che segue è stato scritto da Marianna Avato e appartiene alla tradizione di S. Cosmo A.; si esegue in occasione della festa dedicata a Sant'Antonio da Padova (13 giugno). Il secondo canto è tratto da Giulio Variboba, *Vita della Beata Vergine Maria (1762)*, Ed. critica e trad. italiana a cura di V. Belmonte, Rubbettino, Soveria Mannelli, 2005, pag. 352 (vv. 4260-4275).

Kangjelin e parë çë pason e shkruajti Marianna Avato, dhe i përket traditës së Strigarit; këndohet për rastin e festës së dedikuar Sën Andonit (më 13 theristi). Kangjeli i dytë u muar ka Jul Variboba, Gjella e Shën Mëris s'Virgjër (1762)*, Botim kritik dhe përkthim italisht të përgatitur nga V. Belmonte, Rubbettino, Soveria Mannelli, 2005, pag. 352 (vv. 4260-4275).*

Sën Andon, Sën Andon,
ndihna se kemi bëzonj'.

Sën Andoni predikarni,
gjith' katundet ai xhirarni,
fjalën e mir' ai thoni,
udhën e dreqt' i mbësoni.

Sën Andon, Sën Andon,
ndihna se kemi bëzonj'.

Kush e mban për avukat,
ai pregar dit' e nat'.
Për avukat na gjith' të kemi,
ndihna gjithëve kado jemi.

Sën Andon, Sën Andon,
ndihna se kemi bëzonj'.

Se ky dhe ng'ë' faregjë:
kam vdes edhe t'e lë.
Se ky dhe ësht' i turpruar:
kam vdes t'e lë harruar.

Sën Andon, Sën Andon,
ndihna se kemi bëzonj'.

RRESPONXORI I SËN ANDONIT

Kur ti graxje o mirakulla kërkon,
nisu mbjatu e ço' të Sën' Andon'.
Iken mortja e sendar' Dhimoni,
sa të nisesh të veç tek Sën Andoni.
Pest, sëmund', psor' e guajalli,
gjith' i shëron ky shëjt e pa jatri.
Edhe deti i madh i qell rrëspjet'
e filaqit' e çipet hapen vet.
Kur pe shorta bier ti gjagjë,
edhe sytë ndë ballët, çë do më?
O kopil o pjak moti ti je,
ec njëhere te shëjti se i ke.
Ndër perikul, ndër guaje, ndër dhullur,
majdhe, Sën Andoni ë' protetur.
Nëng e thot' ne një ne dy ne tri,
gjith' dheu e qiella ë' martiri.

(S. Sofia d'E. / Shën Sofi)
KALIMERA E SHËN PJETRIT

Canto che si esegue in occasione della Festa dei SS. Pietro e Paolo (29 giugno)

Kangjel çë këndohet për festën e Shënjtravet Pjetër dhe Pali (më 29 theristi)

Oj Shën Pjeter i bekuer
me ata qyçe çë mban ndër duer,
bashkë me Shën Palin rri
edhe me Zonjën Shën Mëri.

Ti lëreve çdo kishe
e Zotin Krisht sembre seguirte,
andajna ai shumë mirë të dish
e si kullon' të vu mbë qishë.

Ma kur Zotin Krish' e lidhëtin
edhe ti puru e tradhirte,
kur nd'e njihje të pyjtin të tjerë
ti e negove për tri herë.

Ma sa gjeli më këndoi
t'erdh nxe atë çë Krishti të thoi,
se kur gjeli dy herë këndon
për tri herë ti më negon.

Pra u pendirte e tue qarë
apriasu i vajte nd'atë Kallvar.
E kur Zotin Krisht pe mbë kryqë
Besa për të më shumë t'u rrit.

Zoti Krisht të perdunarti
e të dha qyçet e Parrajsit
e kur nd'atë derë një më batir'
ti e xhudikar ndë bëri mirë.

Ndë Parrajsin meriton
e liren e bën të shkonj'.
Bashkë me tij e bën të rri
edhe me u gëlit kumbanji.

Oj Shën Pjetër i bekuer
ti ka gjithë je i kultuer.
Na të truhemi me lotë
parkales për ne Tynzot.

E kur te jetra jetë na vimi
hap Parrajsin e bën të himi.
Bashkë me tij e me Tynzot
tue nderuer na nga mot.

SAN DEMETRIO CORONE
Applausi per il musical "Hair"

Si è svolto sabato 12 nel piazzale antistante al Collegio di Sant'Adriano gremito da tantissimi cittadini sandemetresi, lo Spettacolo Teatrale "Hair", un *musical* recitato e cantato interamente in lingua inglese dagli studenti della Scuola Secondaria di I grado e del Liceo Classico dell'Istituto Omnicomprensivo di San Demetrio Corone, preparati dai professori delle scuole. Un esperimento meritevole di plauso in quanto i ragazzi, ben preparati dai loro professori, hanno dimostrato di essere all'altezza e a proprio agio nell'esprimersi in inglese e hanno recitato da attori consumati. La manifestazione è stata patrocinata dal Comune di San Demetrio.

SHËN MITËR
Duartrokitje për shfaqjen muzikore "Hair"



U mba të shtunë 12 tek sheshi përpara Kullexhit të Shën Adrianit, të mbushur pjot me shënmitrotë, Shfaqja teatrore "Hair", një shfaqje muzikore të recituar dhe të kënduar tërësisht anglisht ka studentët e Skollës së Mesme dhe të Liçeut Klasik të Institutit Omnipërmbledhës të Shën Mitrit, të përgatitur ka profesorët e skollavet. Një eksperiment çë e meriton pëlqimin sepse të rinjtë, të bërë gati mirë ka mësuesit e tyre, e burtuan se janë të afta dhe se gjenden mirë të shprehen anglisht dhe recituan vërteta si aktorë profesionistë. Shfaqja e pati përkrahjen e Bashkisë së Shën Mitrit.

ARBERIA
Incontro con lo scrittore Carmine Abate

Giovedì 3 giugno, presso la Sala Seminari della Biblioteca di Area Umanistica dell'Università della Calabria, si è tenuto un incontro con lo scrittore Carmine Abate, scrittore originario di Carfizzi, organizzato dal Dipartimento di Linguistica dell'Università della Calabria. Sono intervenuti la dr.ssa Fiorella De Rosa, ricercatrice della sezione di Albanologia, la dr.ssa Bruna Adamo, direttore amministrativo del Consiglio di Amministrazione dell'Università, e il prof. Francesco Altimari, responsabile della cattedra di Albanologia.
L'incontro è stata l'occasione per presentare l'ultimo libro edito dalla Mondadori, "Vivere per addizione e altri viaggi", 18 racconti di vita vissuta e poesia, in cui l'autore rivela tutto se stesso.

ARBËRI
Takim me shkrimtarin Carmine Abate

Të ënjten 3 theristi, tek Salla e Seminarëvet të Bibliotekës së sferës umanistike të Universitetit të Kalabrisë, u mba një takim me shkrimtarin Carmine Abate, me origjinë ka Karfici, të organizuar ka Departamenti i Gjuhësisë së Universitetit të Kalabrisë. Muartin pjesë dok.sha Fiorella De Rosa, kërkimtare e degës së Albanologjisë, dok.sha Bruna Adamo, drejtore administrative e Këshillit të Administratës së Universitetit, dhe prof. Francesco Altimari, përgjegjës i katedrës së Albanologjisë.
*Takimi qe rasti sa të paraqitej libri i fundit, të botuar ka Mondadori, "*Vivere per addizione e altri viaggi*", çë janë 18 tregime jetje të rrojtur dhe poezie, në të cilat autori e zbulon vetveten.*

ARBERIA
La musica arbëreshe nella Grande Mela

Si è conclusa l'avventura della Fondazione "Amadeus" di Lungro che ha presentato nel famoso salone del *Borough Hall* di Brooklyn il primo concerto di Anna Stratigò e il cd "Luleborë ensemble" con canti in lingua arbëreshe e albanese. Lo spettacolo è stato preceduto da una relazione sulla cultura e la musica arbëreshe del professor Michelangelo La Luna dell'Università di Rhode Island, originario di Macchia Albanese, frazione di San Demetrio Corone. La manifestazione ha avuto il sostegno dell'Assessorato Regionale al Turismo e della Provincia di Cosenza. Anna Stratigò è stata accompagnata dai musicisti Piero Gallina, al violino e alla lira calabrese, Massimo Garritano alle chitarre e bouzuki, Giuseppe Sergi al basso, Nicola Pisani al sax e Checco Pallone alla chitarra e percussioni.
Presente alla manifestazione il vice presidente della Fondazione "Amadeus", Maurice Cohen. La Luleborë ensemble è stata anche filmata a New York sul ponte di Brooklyn e verrà inserita nel film "Il ritorno di Norman" tratto da un libro di Norman Douglas, per la regia del professore dell'Università della Calabria, Renato Guzzardi, che vede come protagonista Michelangelo La Luna.

ARBËRI
Muzika arbëreshe Nju-Jork

U mbulli aventura e Shoqatës "Amadeus" ka Ungra çë e paraqiti tek salla e famshme Borough Hall *në Bruklin koncertin e parë e Anës Stratigò dhe cd-un "Luleborë ensemble" me këngë arbërisht dhe shqip. Parë shfaqjes u mba një kumtesë mbi kulturën dhe muzikën arbëreshe të mbajtur ka profesori Michelangelo La Luna të Universitetit të Rhode Island, me orgjinë ka Maqi, fraksion e Shën Mitrit. Shfaqja e pati përkrahjen e Asesoratit Krahinor për Turizmin dhe të Provinçës së Kosenxës. Anna Stratigò qe shoqëruar ka muzikantët Piero Gallina, tek violina dhe tek lira kalabreze, Massimo Garritano te kitarat dhe buzuku, Giuseppe Sergi tek basi, Nicola Pisani tek saksofoni dhe Checco Pallone te kitara dhe veglat me perkusion. Ish i pranishëm tek shfaqja nën presidenti i Shoqatës "Amadeus", Maurice Cohen.*
*Grupi "Luleborë ensemble" qe edhe filmuar Nju-Jork mbi urës së Bruklinit dhe ka të hynjë mbrënda te filmi "*Il ritorno di Norman*" i nxjerrë ka një libër ka Norman Douglas, me regjinë e profesorit të Universitetit të Kalabrisë, Renato Guzzardi, çë ka si protagonist Michelangelo La Luna.*

EDITORE / *BOTUES*: Unione "Arberia" / *Lidhja Arbëria*
Sportello linguistico (L. 482/99 annualità 2007) / *Sporteli gjuhësor* (L.482/99 viti 2007)
Sede / *Seli:* San Demetrio Corone / *Shën Mitër*

DIRETTORE RESPONSABILE / *DREJTOR I PËRGJITHSHËM:* Giovanni Luca Baffa

REDAZIONE / *REDAKSIA*
Adriana Ponte, Aurora Stracan, Silvia Tocci, Annunziata Bua, Daniela Zanfini